



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202301033/8

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për bashkërendimin e punës ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Prrenjas për garantimin e mbështetjes financiare për realizimin e projektit "Ndërtimi i shkollës Sali Halili, Rrajcë Fushë"

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

BASHKISË PRRENJAS

PRRENJAS

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), nga publikimi në mediat *online* është vënë në dijeni lidhur me bojkotin e mësimit nga 450 nxënës së bashku me prindërit e tyre në Rrajcë të Bashkisë Prrenjas. Prej dy vitesh nxënësit e fshatit Rrajcë e zhvillojnë procesin mësimor në mjedise që nuk plotësojnë standardet minimale për mësimdhënie, pasi shkolla është dëmtuar nga tërmeti.

Sipas raportimit në media nxënësit së bashku me prindërit e tyre kanë protestuar, duke pretenduar se organet e administratës publike përgjegjëse, Bashkia Prrenjas dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk marrin përsipër financimin e shkollës së re.

Bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454 datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) AP-ja filloi hetimin administrativ për rastin e bërë publik, duke kërkuar informacion zyrtar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Bashkia Prrenjas¹.

Në vlerësim të përgjigjes zyrtare të MAS-it, jemi informuar si vijon:

¹ Shkrese zyrtare me nr.K5/I53-2prot., datë 19.10.2022 të Avokatit të Popullit

- Bashkia Prrenjas, me shkresën nr.1045, datë 06.04.2023 “Kërkesë për financim”, ka aplikuar me projekt-propozimin për financimin/bashkëfinancimin e projektit “Ndërtim i shkollës së mesme “Sali Halili”, 3 kate Rrajcë Fushë”. Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023, në zbatim të ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar me fondet e miratuara nga buxheti i shtetit ka miratuar financimin e 20 projekteve prioritare, të cilat janë vlerësuar sipas drejtimit të thirrjes, kritereve dhe treguesve të vlerësimit. Për vitin 2024, pas shpalljes së thirrjes nga MAS, të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat kanë objekte arsimore për ndërtimin dhe rehabilitimin, duhet të aplikojnë me projekte-propozimet përkatëse, të cilat do të nënshtrohen procesit të vlerësimit sipas drejtimit të thirrjes².

Në shkresën me nr.3177 prot., datë 13.12.2023 të Bashkisë Përrenjas drejtuar AP-së, kjo e fundit informon se “...ky institucion që prej vitit 2020 ka patur si prioritet ndërtimin e shkollës “Sali Halili”, Rrajcë dhe u është drejtuar shumë herë institucioneve përgjegjëse për financimin e projektit. Bashkia Prrenjas është një bashki e vogël me të ardhura të ulta dhe granti që vjen nga qeveria është i ulët për të bërë të mundur ndërtimin e shkollës “Sali Halili”, Rrajcë Fushë...”. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresës zyrtarë kanë dërguar dhe kopje të kërkesave për financim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financës.

Në vijim të hetimit administrativ, me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave të sipërcituara, AP-ja i ka kërkuar zyrtarisht informacion shtesë MAS-it lidhur me faktin nëse është miratuar projekt-propozimi për financimin/bashkëfinancimin e projektit “ndërtimi i shkollës së mesme të bashkuar “Sali Halili”, 3 kate, Rrajcë Fushë të Bashkisë Përrenjas³ dhe nëse jo, cilat janë kriteret dhe treguesit që nuk ka përmbushur Bashkia Prrenjas bazuar në udhëzimin nr.9, datë 27.4.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”.

Në shkresën me nr.7277/3 prot., datë 22.12.2023 MAS-i informon se “...Numri i aplikimeve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore në vitin 2023 ishte gjithësej 43 aplikime, ndërsa numri i projekteve fituese,

² Shkresa zyrtare me nr.7277/1 datë 01.12.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

³ dërguar me shkresën zyrtare nr.1045 prot., datë 6.4.2023 “Kërkesë për financim” pranë MAS-it në zbatim të ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”

përcaktohet në varësi të fondeve në dispozicion për çdo program buxhetor si dhe në përmbushje të kriterëve specifike. Projekti i paraqitur nga bashkia Prrenjas për ndërtimin e shkollës së mesme të bashkuar “Sali Halili”, 3 kate, Rrajcë Fushë me vlerën 98.113.543 (nëntë dhjetë e tetë milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë është vlerësuar me 42 pikë nga 100 pikë të mundshme. Vlerësimi i aplikimeve për pikëzimin e çdo kriteri kryhet nga sekretariati teknik i MAS, sipas metodologjisë së përcaktuar, përkatësisht për projektin si vijon:

- 1. Shkalla e ndikimit në arritjet e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes: vlerësuar me 10 pikë nga maksimalisht 15 pikë;*
- 2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi i projekteve të propozuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë të detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikuesi, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësuar me 10 pikë nga maksimalisht 25 pikë. Projekti teknik i paraqitur nga bashkia Prrenjas është klasifikuar me mangësi/projekt jo i plotë, pasi kanë munguar detajet teknike (projekti elektrik, hidraulik, sistemi i ngrohjes) numri i klasave të planifikuara tejkalon raportin nxënës/klasë ç’ka ka rritur vlerën e projektit dhe koston për nxënës. Numri i klasave shtesë mund të zëvendësohet me ambiente të mbyllura sportive, të cilat mungojnë në projektin e paraqitur. Relacioni teknik i paraqitur nga projektuesi nuk i referohet ndërtimit të objektit por paraqet elementë të përgjithshëm të infrastrukturës, përfshi punime rikonstruksioni ndërsa projekti i kërkuar është ndërtim i ri.*
- 3. Ndikimi i projekteve dhe avantazhet në lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, ndërveprimet midis zonave urbane e rurale duke rritur mbulimin në shërbime, edhe përmes shkollave me numër të vogël nxënësish, zgjidhjen e nevojës emergjente për ndërhyrje, përmirësimin të cilësisë së shërbimit dhe jetës komunitare dhe më gjerë, zhvillimin ekonomik-social, parë nga ana e përfituesit, qytetarit: ky kriter vlerësuar me 10 pikë nga maksimalisht 25 pikë.*
- 4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësuar me 2 pikë nga maksimalisht 10 pikë);*
- 5. Numri i përfituesëve në mënyrë të drejtpërdrejt dhe/ose të tërthortë (nxënës/mësues/komunitet) nga projekti ose zona kryesore dhe*

dytësore e ndikimit/mbulimit të shërbimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesëve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me 6 pikë nga maksimalisht 15 pikë;

6. *Niveli i bashkëfinancimit përmbi vlerën dysheme (minimale) të bashkëfinancimit, me fonde të tjera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, apo me fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me 4 pikë nga maksimalisht 10 pikë.*

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të organeve të administratës publike (Bashkisë Prrenjas dhe MAS) dhe bazës ligjore për financimin dhe realizimin e shërbimit arsimor publik, AP-ja konstaton se MAS-i dhe Bashkia Prrenjas e kanë të qartë rolin e tyre në lidhje me kompetencat dhe përgjegjësitë për të mundur bashkërendim të punës lidhur me përmirësimin e infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar. MAS-i vazhdon të akordojë fonde për ndërhyrje në infrastrukturën shkollore, pajisjen e tyre me bazën materiale dhe materiale didaktike, laboratore shkencore, pajisje kompjuterike apo kabinete informatike duke iu dhënë mundësinë njësitë të qeverisjes vendore të përfitojnë fonde duke aplikuar me projekte-propozime konkrete, të cilat i nënshtrohen procesit të vlerësimit sipas drejtimit të thirrjes.

AP-ja bazuar në rastet e trajtura në vazhdimësi lidhur me përmirësimin e infrastrukturës shkollore me keqardhje ka konstatuar se fondet në dispozicion janë thelbësisht të pamjaftueshme për adresimin e këtyre problematikave. Mbetet i pamjaftueshëm impakti i MAS-it në realizimin efektiv të të drejtës për arsim cilësor, pasi delegimi në pushtetin vendor nuk shënjestron politika të përshtatshme në çdo lloj bashkie dhe krijon vështirësi, sidomos për bashkitë me fonde të vogla/pa fonde të mjaftueshme.

Fondet e parashikuara për periudhën 2022-2024, sipas strukturës të grup-artikujve buxhetorë të shpenzimeve për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në zërin infrastruktura –investimet, planifikimi i fondeve për grupin e shpenzimeve kapitale për këtë periudhë (2022-2024) në arsimin parauniversitar janë parashikuar **17 miliard e 149 milion lekë**, të detajuar për çdo vit të PBA me një rritje mesatare që shkon nga 48.2% në 11.2%. Fondet për investime kapitale në vitin 2022, janë 4 miliard e 231 milion lekë ose 48% e fondeve të miratuar për MAS 2021. Në vitin 2022, ka një rritje prej 1.28 miliard lekë ose 48.3%

- në vitin 2023 fondet për investime arrijnë në 4 miliard 734 milion lekë ose 12.8% e fondeve të miratuar për MAS me një rritje prej 503 milion lekë ndaj vitit 2022,
- **në vitin 2024 fondet për investime arrijnë në 5 miliard 234 milion lekë ose 10% e fondeve të miratuar për MAS, me një rritje prej 500 milion lekë ndaj vitit 2023 ose 11.3% më shumë se në vitin 2023⁴.**

MAS-i ka miratuar aktin nënligjore për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionet e nevojshme për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, konkretisht:

- për vitin 2023 vlera e financimit nga MAS-i për programin buxhetor 09120 “Arsimi Bazë” ka qënë në shumën prej 724 380 000 lek (shtatë qind e njëzetë e katër mijë e e treqind e tetëdhjetë milion lekë)⁵.

Nga sa më sipër rezulton se MAS-i disponon fonde për investime në arsimin parauniversitar, ku përfshihet arsimi bazë për periudhën 2022-2024. Bashkia Përrenjas, për rastin në fjalë (shkolla Sali Halili, Rrajcë Fushë) nuk ka qënë përfituese e fondeve të MAS-it, pavarësisht se ka aplikuar për financimin e projektit në thirrjet e saj.

Bazuar në pikën 8, të udhëzimit nr.9/2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive” (udhëzimi nr.9/2022) “..në të gjitha rastet, kur në shpalljen e thirrjes për aplikim parashikohet bashkëfinancimi i projektit, NJVV-ja duhet të paraqesë në aplikim edhe konfirmimin zyrtar të miratuar nga organi kolegjal i NJVV-së, i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen përsipër të pjesës taksuese të bashkëfinancimit. Aplikimi nuk i nënshtrohet procesit të shqyrtimit, në rast të mungesës së këtij dokumenti”.

MAS-i në rastin konkret ka shqyrtuar projektin e paraqitur nga bashkia Përrenjas për ndërtimin e shkollës së mesme të bashkuar “Sali Halili”, 3

⁴Relacion mbi hartimin programit afatmesëm buxhetor për periudhën 2022-2024, për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, (fq 20)

⁵Urdhëri nr.146, datë 24.3.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2023-2024”

kate, Rrajcë Fushë dhe ka udhëzuar Bashkinë Përrenjas të përmirësojë kriteret e projektit sipas metodologjisë së përcaktuar nga MAS-i.

AP-ja shpreh shqetësimin se një ndër elementët e largimit të të rinjve nga vendi ynë lidhet dhe me moskrijimin e mjediseve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor cilësor, sidomos në zonat rurale të vendit. Institucionet kanë detyrimin të sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe, të drejtat e tyre të mos shkelen, kjo me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme jo vetëm për realizimin e procesit mësimor por edhe të veprimtarive me karakter sportiv, edukativ, kulturor e dëfryes, në përshtatje me moshën e tyre.

Ekzistenca e një godine funksionale dhe mirëfunksionimi i mjediseve të brendshme të saj, me mjetet dhe pajisjet e nevojshme, është e rëndësishme për zhvillimin korrekt dhe sipas standardeve të procesit të edukimit/arsimimit dhe aftësimin fizik të fëmijëve/nxënës⁶. Arsimimi i fëmijës duhet të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të tij⁷. Prandaj, është e nevojshme të merren të gjitha masat, për krijimin e mundësive infrastrukturore të përshtatshme, ku përpos edukimit, t'i nxisim fëmijët edhe drejt një qasjeje të realizimit të plotë të të gjithë orarit mësimor.

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, parashikojnë se: “... *arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës...*”.

Ndërkaq, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të marrin masa konkrete që të inkurajojnë, motivojnë dhe të rrisin cilësinë e arsimimit të fëmijëve/nxënës, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimin të mjeteve të domosdoshme mësimore⁸, me qëllim edukimin dhe aftësimin e fëmijëve. Kjo e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme shkon paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivi 4.1), i cili pohon rëndësinë e sigurimit të një arsimi gjithëpërfshirës, me cilësi të barabartë dhe

⁶“Program mësimor” është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

⁷ Shkronja “a”, e nenit 29, e Konventës të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

⁸ Shkronja “e”, e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët/nxënësit të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, në mënyrë cilësore, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të nxënit.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999 AP-ja:

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga Bashkia Prrenjas për përmirësimin e projekt-propozimi për financimin/bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i shkollës së mesme të bashkuar “Sali Halili”, 3 kate, Rrajcë Fushë projektit në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Marrjen e masave nga Bashkia Prrenjas për miratimin e fondit nga buxheti i saj në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr.9, datë 27.4.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”.
- Marrjen e masave nga Bashkia Prrenjas për të aplikuar me projekt-propozimin e përmirësuar për vitin 2024, pas shpalljes së thirrjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të gjitha Njësive të Vetëqeverisjes.
- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për trajnimin e punonjësve përkatës për ndjekjen e paraqitjen e projekteve, të paktën sa herë ndryshon rregullorja dhe ekipi i drejtuesve të Njësive të Qeverisjes Vendore.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ